



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE

AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 14.06.2023 |
| REFERENC-Ë: | DPKI-06-682/23 |
| PËR/ZA/TO: | Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës |
| CC: | z. Behar EJUPI, Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ylli BULESHEKAIJ, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit |
| NGA/OD/FROM: | Esad EJUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit |

Dep. 06/02 Nr.Prot.
Dep. Br.Prot.
Dep. Prot No. 1216/23
Nro.Paq. 03 Data
Br. Str. Datum
Nr. Page. Date
14.06.2023



Të nderuar,

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), pas informatave të pranuara nga jashtë me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me z. Behar Ejupi, Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës (në vijim: OAK), konform kompetencave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të LPKI-së, nxjerrë këtë:

OPINION

Marrja pjesë dhe votimi i z. Behar Ejupi, në cilësi të anëtarit të Këshillit Drejtues të OAK-së, për raportet financiare lidhur me shpenzimet të cilat ai i kryen në cilësi të Kryetarit të OAK-së, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së.

Arsy etim

Agjencia ka pranuar një informatë nga jasht - raportuesi i rastit (DPKI-06-682/23), lidhur me z. Behar Ejupi, Kryetar i OAK-së, njëherit anëtar (*ex lege*) i Këshillit Drejtues të OAK-së, sa i përket dyshimit të ngritur për konflikt të interesit si në vijim: “*.../ marrja pjesë, ushtrimi i ndikimit dhe votimi i Kryetarit të Odës së Avokatëve Behar Ejupi, nga cilësia e anëtarit të Këshillit Drejtues, a paraqet Konflikt Interesi votimi i tij sa i përket raporteve financiare, në të cilat raporte përkufizohen edhe shpenzimet të cilat ai i kryen nga buxheti i OAK-së*”.

Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit në kuptim dispozitave të LPKI-së.

Me qëllim të mbledhjes së informatave dhe dokumentacionit relevant për sqarimin e situatës, Agjencia (paraprakisht) përmes shkresës zyrtare DPKI-06-02/880/23, ka kërkuar nga OAK informata dhe sqarime, përfshirë dokumentacionin relevant dhe bazën ligjore të OAK-së, sa i përket dyshimit të ngritur për konflikt të interesit. OAK duke u përgjigjur në kërkesën si më lartë, ka dërguar në Agjenci përgjigjen (DPKI-06/02-880-1/23) dhe plotësimin e përgjigjes (DPKI-06/02-880-2/23).

Përmes përgjigjes si më lartë, OAK ka sqaruar kompetencat (detyrat dhe përgjegjësitë) që kanë organet e saj (kryetari dhe këshilli drejtues) në çështjet financiare, konform legjislacionit të OAK-së (Ligjit për avokatinë, Statutit të OAK-së dhe Rregullores për menaxhimin financier të OAK-së). Në përgjigjen e OAK-së, ndër të tjera theksohet se:

“[...] Kryetari dhe Këshilli Drejtues janë organe të pavarura brenda OAK. Kryetari ka kompetenca në çështjet financiare dhe lejon të gjitha pagesat konform kësaj normative [...] Këshilli Drejtues në përbërjen e tij ka Kryetarin e OAK-së, i cili sipas detyrës zyrtare e udhëheq këtë organ [...]. Këshilli Drejtues, si organ kryesor menaxhues i OAK-së, sipas kompetencave ka për obligim shqyrtimin e raporteve financiare të OAK-së në baza mujore. Çdo pagesë që bëhet nga OAK, pasqyrohet në raportin financier i cili i shkon për miratim Këshillit Drejtues[...].

Të gjitha pagesat në OAK i lejon Kryetari [...] konform normativës së lartëcekur. Kjo vlenë edhe për shpenzimet që krijojnë degët regionale që udhëhiqen nga kryetarët e degëve, të cilët sipas detyrës zyrtare janë pjesë e Këshillit Drejtues. Shpenzimet të cilat i krijojnë kryetarët e degëve, janë pjesë e raporteve financiare të cilat i votojnë vet kryetarët e degëve si anëtarë të Këshillit Drejtues, sikurse që është pjesë e KD-së edhe kryetari i OAK-së. E që nga kjo kuptohet se të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues krijojnë shpenzime për të cilat Këshilli Drejtues voton.

[...] Këshilli Drejtues ka për obligim të shqyrtoj raportet financiare mujore. [...] Kryetari i OAK-së, ka obligim ligjor që të marrë pjesë dhe të votoj për çështjet që janë në kompetencën e Këshillit Drejtues. [...]”

Agjencia, pasi ka analizuar informatën e pranuar nga raportuesi i rastit, si dhe informatat dhe sqarimet e pranuara nga OAK përkitazi me kompetencat e kryetarit dhe këshillit drejtues të përcaktuara me legjislacionin e OAK-së, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të LPKI-së, konstatoi si në dispozitiv të këtij opinioni.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkusituar nociioni i konfliktit të interesit, ashtu që: “*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*”, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: “*Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të rjoburive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të*

lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: “*interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhëniet afariste*”, si dhe me nënparagrafin 1.12 të këtij neni, me të cilin është definuar nocioni i vendimmarrje si: “*çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.*”

Në kuptim të dispozitave si më lartë, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo *personat e afërm*.

Në rastin konkret, marrja pjesë dhe votimi i z. Behar Ejupi, në cilësi të anëtarit të Këshillit Drejtues të OAK-së, për raportet financiare lidhur shpenzimet të cilat ai i kryen në cilësi të Kryetarit të OAK-së, nuk ka të bëjë me *vendimmarrje* për *interes privat*, por siç është theksuar nga përgjigja e OAK-së, kjo *vendimmarrje* është në funksion të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij si Kryetar i OAK-së, njëherit anëtar (*ex lege*) i Këshillit Drejtues të OAK-së, të përcaktuara me legjislacionin e OAK-së. Rrjetohimisht, gjithnjë sipas përgjigjes zyrtare të OAK-së, *vendimmarrja* si më lartë e z. Behar Ejupi, ka të bëjë me ndërlidhjen e kompetencave të pozitave (Kryetar dhe njëherit anëtar *ex lege* i Këshillit Drejtues të OAK-së) që z. Behar Ejupi i ushtron në OAK.

Për më tepër, në kuptim të dispozitave të LPKI-së, e tillë konsiderohet edhe *vendimmarrja* e anëtarëve tjerë të Këshillit Drejtues të OAK-së (kryetarë të degëve regionale) përkizati me raportet financiare për shpenzimet të cilat ata i bëjnë në degët regionale të OAK-së, përderisa të njëjtë nuk kanë *interes privat* lidhur me *vendimmarrjen*.

Agjencia, me rastin e nxjerrjes së këtij opinioni ka pasur parasysh edhe pretendimet e OAK-së sipas plotësimit të përgjigjes (DPKI-06/02-880-2/23), por të njëjtat nuk ndikuan në trajtimin apo vendosjen ndryshe.

Ky opinion i referohet vetëm situatës konkrete për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së dhe nuk trajton çështje tjera. Agjencia ka trajtuar pretendimet e parashtruara vetëm në kontekst të situatave të mundshme të konfliktit të interesit dhe ndalesave të përcaktuara me dispozitat e LPKI-së, pretendimet tjera që janë jashtë sferës së konfliktit të interesit, përkatesisht jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë, të trajtohen dhe zgjidhen brenda mekanizmave e institucioneve tjera kompetente.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!